



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 4 dhjetor 2014, në mbledhjen VII – të (shtatë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.00’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesuesi i këtij Komiteti. Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Bahri Selimi, z. Mefail Rama, z. Radisav Perović, z. Shaban Osmani, z. Xhafer Ademi dhe z. Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Ylber Salihu, zyrtar për Integritet Evropian, z. Bashkim Bajrami, Komanda Rajonale Kufitare – Veriu, z. Fadil Babatinca, Stacioni i Policisë në Podujevë, z. Muharrem Haziri, OSBE dhe János Farkas, LMT.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25 nëntor 2014

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Propozimi i Planit të punës për vitin 2015

z. Shaban Osmani, theksoi, Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve, i ngritur në mbledhjen e kaluar, e ka hartuar propozimin e Planit të punës për vitin e 2015, i cili u është dërguar me kohë të gjithë anëtarëve të këtij Komiteti dhe shtoi, nëse pajtoheni unë do ta lexoj propozimin e Planit dhe ju ftoj që lirshëm të paraqitni vërejtje, plotësime apo sugjerime në mënyrë që ky Plan të jetë sa më përmbajtësor dhe funksional.

z. Fadil Babatinca, propozoi që në muajin mars të bëhet një vizitë nxënësve me nevoja të veçanta në Shkollën fillore “ Kongresi i Manastirit në fshatin Gllamnik, ku në mesin e 27 nxënësve është edhe një pjesëtar i komunitetit ashkali, në mënyrë që kjo kategori të bëhet me dije se së paku e ka një mbështetje morale.

z. Liman Zeqiri, theksoi, propozimi i këtij Plani është hartuar në mënyrë të mirë, kuptohet plani mund të ndryshoj varësisht nga rrethanat e krijuara. Detyrat e

përhershme janë identifikuar dhe evidentuar mjaftë mirë, detyra të cilat janë obligime kushtetuese, ligjore por edhe obligime sipas Konventave ndërkombëtare. Në shtator 2015 është paraparë, identifikimi i personave të komuniteteve pakicë të cilët e kanë ndërprerë shkollimin e mesëm dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor joformal për përfundimin e klasave përkatëse, në këtë kontekst Ju informoj se në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, është i ngritur një komision i cili është funksional, unë kam qenë kryetar i atij komisioni dhe në bazë të analizave e hulumtimeve që i kemi bërë nëpër shkolla kemi konstatuar se një numër i fëmijëve e braktisin shkollimin dhe kryejnë punë të rënda, se ata fëmijë kryesisht janë të përkatësisë të komuniteteve RAE dhe se shkaktare e kësaj është gjendja e rëndë sociale dhe ekonomike.

Andaj nëse identifikojmë nxënës i cili e ka braktisur shkollimin dhe merret me punë të rënda, kjo është shkelje e të drejtave të fëmijëve.

Gjithashtu propozoj që ky Komitet të shqyrtoj mundësitë për sigurimin e kushteve për krentimin e festës së flamurit të komunitetit ashkali dhe flamurit të komunitetit rom, përkatësisht miratimin e rekomandimeve Drejtorive kompetente për sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme.

Sa i përket Raportit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, është rregull që kjo Zyrë të raportoj në periudhën njëvjeçare, andaj do të ishte mirë që kjo mënyrë të parashihej edhe në këtë Plan pune, por për mua edhe nëse mbetet që të raportohet në çdo gjashtë muaj nuk ka kurrfarë problemi.

Pajtohem se është në interes shkëmbimi i përvojave me Komitetet e Komuniteteve dhe vizitat në komunat e propozuara, mirëpo jam i mendimit se kësaj do duhej t'i shtohet, edhe komunat tjera të cilat shprehin interesim për bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave dhe në këtë kontekst do të ishte mirë që ky Komitet të organizoj një takim pune me përfaqësuesit e Komiteteve për Komunitete të komunave të regjionit Prishtinës.

Sa i përket bashkëpunimit të këtij Komiteti me subjekte të tjera, konsideroj se kësaj do duhej t'i shtohet edhe Qendra për Dokumentimin e Romëve dhe Ashkalive, RADAC.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan propozimet:

- Monitorimi për identifikimin e fëmijëve të cilët merren me punë të rënda.
Detyrë e përhershme
- Raporti i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
Shkurt 2015
- Vizitë nxënësve me nevoja të veçanta në Shkollën fillore " Kongresi i Manastirit në fshatin Gllamnik,
- Shqyrtimi i mundësive për ofrimin e ndihmës financiare (miratimin e rekomandimit) për organizimin e festës së flamurit të komunitetit ashkali.

- Shqyrtimi i mundësive për ofrimin e ndihmës financiare (miratimin e rekomandimit) për organizimin e festës së flamurit të komunitetit rom.
Mars 2015

- Pjesës te vizitat e Komitetit për Komunitete, në fund shtohet edhe:
Komunat tjera të Republikës së Kosovës të cilat shprehin interesim për bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave.
- Organizimi i një takimi pune me përfaqësuesit e Komiteteve për Komunitete të komunave të regjionit Prishtinës.
Qershor 2015

- Pjesës te bashkëpunimi, në fund i shtohet Qendra për Dokumentimin e Romëve dhe Ashkalive, RADAC.

Në vazhdim pas propozimeve të bëra, njëzëri u miratua propozimi që mbledhjet e Komitetit për komunitete të mbahen në javën e parë të çdo muaji, përveç muajit gusht kur është paraparë pushim.

z. Muharrem Haziri, theksoi, sot e zëvendësoj një koleg timin, mirëpo dëshiroj të potencoj një çështje të cilën e kam potencuar edhe në disa takime tjera dhe shtoi, sipas propozimit të Planit të punës janë përmendur shumë aktivitete mirëpo shumica e këtyre aktiviteteve kanë implikime financiare e kjo çështje nuk është paraparë as në këtë plan e as në ndonjë dokument tjetër.

Jeni në dijeni se përgatitja e buxhetit të Komunës kalon nëpër disa faza, andaj do duhej që nga muaji prill i vitit përkatës fiskal, atëherë kur arrin Qarkorja e parë buxhetore të bëhen propozime konkrete për aktivitetet e parapara, për vitin 2015 kjo çështje ka përfunduar mirëpo në vitin 2016 ka mundësi që për këtë Komitet të parashihet një shumë e caktuar buxhetore. Tri vitet e fundit sa unë jam në Podujevë nuk kamë parë se ndonjë anëtar i Komitetit për Komunitete ka bërë ndonjë propozim në këtë drejtim apo i ka paraqitur ndonjë kërkesë strukturave relevante të Komunës.

z. Liman Zeqiri, theksoi, e kuptoj parafolësin për faktin se nuk e ka përcjellë në vazhdimësi punën dhe aktivitetet e këtij Komiteti, mirëpo në realitet kurrë, në asnjë rast, Komuna nuk ka paraqitur pengesë për realizimin e ndonjë aktiviteti kur janë nevojitur mjete financiare e aq më pak kur është nevojitur ndonjë automjet zyrtar. Lirshëm mund të them se çdo herë kanë pasur mirëkuptim, i kemi të dhënat statistikore, se në lëmin e shëndetësisë, arsimit, buxhetit etj., gjithherë është ofruar ndihma e mundshme. Në këtë vit prej buxhetit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, komuniteti ashkali është ndihmuar me shumë të caktuar të mjeteve financiare me rastin e kremtimit të festës së flamurit festës së flamurit.

Pajtohem se më mirë është që ky Komitet ta ketë buxhetin e vet, mirëpo në asnjë mënyrë nuk pajtohem se ndonjë aktivitet nuk është realizuar për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

4. Të ndryshme

z. Muharrem Haziri, theksoi, e kam një kërkesë prej zyrtarëve të cilët e përcjellin punën e këtij Komiteti e cila ka të bëjë me të dhënat për personat dhe familjet e

emigruara kohëve të fundit të komuniteteve RAE dhe shtoi, do të jemi mirënjohës nëse na i përcillni informacionet e kërkuara.

z. Xhafer Ademi, parafolësin e njoftoi se kohëve të fundit pjesëtarë të komuniteteve RAE kanë emigruar 25 familje me 107 persona dhe prej tyre janë 42 nxënës.

Në vazhdim u vendos që mbledhja e radhës të mbahet më 6 janar 2015.

Mbledhja përfundoi në orën 11.40’.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01-006-100828

**Podujevë,
4 dhjetor 2014**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**